

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve B. H. dhe R.H. nga fshati P., Komuna e P., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1896/14 të dt. 06.05.2015, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.10.07.2017, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Rukije Sheshivari dhe të akuzuarve, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 20.07.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

B. H., nga i ati I. dhe nëna S., e vajzërisë I., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin M., tani me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i 2 (dy) fëmijëve, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

R. H., nga i ati I. dhe nëna S., e vajzërisë I., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin M., tani me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i 1 (një) fëmije, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

S e p s e :

Me datën 17.01.2014, rreth orës 12:00, në pyllin publik të quajtur “O. e H.”, në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të S., me të cilin menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari – Sektori i Pylltarisë në P., të pandehurit me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, janë zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 15 copë trungje të llojit ah, me sharrë motorike dhe traktor, me dimensione: 15 metra të gjata, diametër 40-52 cm, me vëllim të përgjithshëm 11.40m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Podujevë, i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 17, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463 të KPPPK-së, i

G J Y K O N

Të akuzuarit: **B. (I.) H. dhe R. (I.) H.** secilin veç e veç me **dënim me kusht**, ashtu që iu shqipton dënim me **burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit **brenda afatit prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejn vepër të re penale, si dhe secilin veç e veç me **dënim me gjobë** në shumë prej **180€ (njëqindëtetëdhjetë/euro)**, të cilin dënim **obligohen ta paguajnë** brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë brenda afatit të caktuar më lartë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës, do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim

Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushalle të paguajnë secili veç e veç shumën prej **20€ (njëzetë/euro)**, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - K. P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1896/14 të dt. 06.05.2015, kundër të akuzuarve B. H. dhe R. H. nga fshati P., Komuna e P., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.07.2017 në praninë e Prokurorit të Shtetit, Rukije Sheshivari dhe të akuzuarve B. H. dhe R.H.

I akuzuari B. H. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës, këtë e kam bërë për shkak se jam i gjendjes së rëndë ekonomike, pasi që jamë i pa punë, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale.

I akuzuari R. H. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës, këtë e kam bërë për shkak se jam i gjendjes së dobët ekonomike, pasi që jamë i pa punë, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit për veprën penale Vjedhje pylli të kryer në bashkëkryerje deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë, ngase është bërë vullnetarisht, pa presion në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve B. H. dhe R. H. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës dhe të njëjtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimit të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata në shqyrtim gjyqësor nuk pati kërkesë nga pala e dëmtuar për kompensimin e dëmit dhe nuk pati ndonjë ekspertizë nga ekspertë të pavarur lidhur me vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga i akuzuari.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.439/2015, datë:20.07.2017

Sekretarja juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.